REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË 30.09.2021

Me datë 30.09.2021, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër.Këshilltarë të pranishëm ishin: Teuta Zaja,Brisela Kadija, Bledianë Nika,Ermina Gruda,Aurora Dibra,Tereze Brigja,Ardiana Ndreu, Diana Muriqi,Jona Leqejza, Vjollca Petani,Ardita Spahija,Dhurata Tyli,Age Martini,Donika Ndoja,Valbona Doniku, Suada Selimaj,Lumnije Guri,Ornela Leka,Erion Metushi,Luan Heta, Oltion Luli,Julian Kraja, Hilmi Lakti,Avenir Celaj,Marjan Ndershtiqaj,Sead Cocja, Lush Marku,Sokol Zaimaj,Hekuran Gjorreta, Besmir Vukaj, Anton Deda, Blerim Dimnaku,Gjergj Sokoli, Andi Hallunaj,Nadir Spahija,Lindita Nika,Arbis Vjerdha.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Gusht 2021".*

2. Pr/ Vendim *"Për miratimin e rregullores për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave,vërejtjeve,kërkesave ,peticioneve dhe iniciativave qytetare."*

3. Pr/ Vendim *"Për dhënie pëlqimi për dhenie me qira të ekonomisë pyjore Pruemos Sheldi,Njësia administrative Rrethina,bashkia Shkodër,ngastra 50°,me sip.250 m2,me afat,5 vjecar për vendosjen e antenës të komunikimit të operatorit të telefonisë celulare "One telecommunications sh.a"*

4. Pr/ Vendim *"Për miratimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Brucaj,njësia administrave Pult Bashkia Shkodër"*

5. Diskutime jashtë rendit të ditës.

1.Mbledhja vijon me paraqitjen e rendit të ditës nga Kryetarja e Këshillit,e cila shprehet se ka dy këerkesa per të bërë shtesë në rendin e ditës.Kërkesa e parë vjen nga këshilltarja Suada Selimaj,ne lidhje me plotësimin e vakancës në Këshillin bashkiak,dhe kërkesa e dytë e ardhur nga Z.Vjerdha bën fjalë për kerkesën e tij për të shtuar një pikë të vecantë për dikutime te ndryshme.

Sipas rregullores kërkesa e Znj.Selimaj do jetë pika e fundit e rendit të ditës,ndërsa në lidhje me kërkesën e Z.Vjerdha,për shkak të specifikimeve të kërkuara nga rregullorja do mbetet tek pika e diskutimeve të lira,përndryshe duhet të zbatohet neni 98 pika 4 dhe neni 51 pika 17 e rregullores së re.

Fjalen e merr Z.Vjerdha i cili shpreh dakortësi,por mendon që problemet e shumta të qytetit nuk mund të marrin përgjigje ne një mbledhje te vetme.

Kryetarja e Këshillit,sqaron se sipas rregullores,Këshilli mblidhet nje herë në muaj dhe asnjëherë nuk është kaluar numri i çështjeve për rend dite.

Z.Vukaj merr fjalën dhe propozon qe draftin e rregullores së re ta trajtojnë në mbledhjen e ardhshme meqënese kërkon më shumë kohë për trajtim.Znj.Kadija sqaron që rregullorja që mund të miratohet sot mund të rishikohet dhe saktësohet edhe në vazhdim.

Edhe Z.Marku kërkon shtyrjen e miratimit të draft rregullores me arsyetimin se ajo nuk ka kaluar ne komisionin e ligjeve të këshillit bashkiak.

Z.Kadija,sqaron se Pr/Rregullorja ka ardhur nga Bashkitë e forta dhe ka pasyr ndryshime,por nëse shihet e arsyeshme mund të shtyhet për mbledhjet në vazhdim.

Kryetarët e grupeve jane dakort me rendin e ditës.Hidhet në votim propozimi i Z.Marku për heqjen nga rendi i ditës i Pr/Rregullores.Vota____ Pro,Kundër___,Abstenim____.
Nuk miratohet.
Hidhen në votim propozimi i Znj.Selimaj për plotësimin e vakancës, ku rezultojnë ___ vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.
Miratohet

---

2. Mbledhja vijon me projektvendimin *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Gusht 2021"*. Relaton drejtoresha e Ndihmës e Ekonomisë,sipas materiali të përgatitur nga administrata.

Pason me pyetje Z.Vjerdha,i cili kërkon të dijë nëse bashkia ka punësuar persona përfitues të listës së ndihmes ekonomike,nëse jo,në bazë të cfarë kriteresh punësohen punonjësit e ri të administratës?

Nënkyetari bashkisë Z.Dedaj merr fjalën dhe sqaron se kriteret që ndiqen për punësim në administratë janë të specifikuara në ligj,dhe kushdo që mund t'i plotësojnë keto kritere është i lirë

të konkurojë.Por vlen të theksohet,që bashkia ne projektet e saj ka patur gjithmonë në fokusin e saj të punësojë persona të listës përfituese.

Kryetarët e grupeve shprehen pro. Hidhen në votim Pr/Vendimi, ku rezultojnë ___ vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

3. Mbledhja vijon me projektvendimin *"Për miratimin e rregullores për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave,vërejtjeve,kërkesave ,peticioneve dhe iniciativave qytetare."*

Kryetarja e këshillit,sqaron se secili nga këshilltarët ka nga një relacion sqarues në lidhje me ketë rregullore,i cili tregon edhe rëndësinë e rregullores.

Znj.Nika mendon që rregullorja duhet rishikuar dhe duhen bërë ndryshimet përkatëse.Ndërsa Z.Vjerdha mendon që rregullorja duhet miratuar dhe të rishikohen në nje moment të dytë.

Znj.Martini,shprehet që secili nga këshilltarët ka pasur kohë të mjaftueshme për tu njohur dhe për të shprehur padakortësi me rregulloren.

Kryetarët e grupeve shprehen pro. Hidhen në votim Pr/Vendimi, ku rezultojnë ___ vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

4. Mbledhja vijon me projektvendimin Pr/ Vendim *"Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomise pyjore Pruemos Sheldi,Njësia administrative Rrethina,bashkia Shkodër,ngastra 50 ,me sip.250 m2,me afat,5 vjecar për vendosjen e antenes të komunikimit të operatorit të telefonisë celulare "One telecommunications sh.a"*

Fjalën e merr Znj.Shllaku e cila relaton sipas materialit të përgatitur nga administrata.Znj.Dibra vlerëson iniciativën e marrë,kurse Z.Vjerdha kërkon të dijë nëse do ketë iniciativa në parandalimin e prerjes së drunjve.

Hidhen në votim Pr/Vendimi, ku rezultojnë ___ vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

5. Vazhdohet me Pr/ Vendim *"Për miratimin e planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Brucaj,njesia administrave Pult Bashkia Shkodër".Relaton Znj.Shllaku* sipas materialit të përgatitur nga administrata.Pyetje diskutime nuk ka. Hidhen në votim Pr/Vendimi, ku rezultojnë ___ vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

6. Kalohet ne pikën shtesë të rendit të ditës,të propozuar nga Znj.Selimaj.Relaton Zn.Murici.Hidhet në votim propozimi për plotësimin e vakancës. ku rezultojnë ___ vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Bëhet betimi i Këshilltares së re.

7. Vazhdohet me diskutime jashtë rendit të ditës.Fjalën e merr Znj.Tyli,e cila i drejtohet nënkryetarit të bashkisë,për të marr informacion me ecurinë e rrugës tek monumenti "Dëshmorët e Kombit".Po ashtu ajo ngre edhe shqetësimin për mbeturinat tek zona e thertores dhe kërkon informacion se cfarë masash jane marr nga bashkia.

Fjalën e merr Z.Deda i cili sqaron se persa i takon rrugës,ka një fond dhe një projekt për këtë por janë procedurat e tenderimit që kane afatet e tyre dhe kjo nuk varet nga askush.Kurse për pyetjen e dytë,ai mendon se mbeturinat mund të krijohen brenda ditës dhe kjo s'do të thotë se kompania e kontraktuar nuk ka punuar për këtë.

Fjalën e merr Znj.Leqejza,e cila shpreh shqetësimin e banorëve të rrugës "Muhamet Dibra" pranë Stadiumit "Loro Borici",ku rezulton që i gjithë kalldrëmi në atë zonë eshtë dëmtuar nga qarkullimi i pakontrolluar i mjeteve të tonazhit të rëndë,kur në fakt kjo pjesë duhej të përdorej për aktivitete e grumbullime sportive.Ajo mendon që ky fenomen ndodh nga mospasja e nje plani të mirëfilltë mobiliteti,ku mungojnë edhe terminalet.Vlen të theksohet që edhe në një dëgjesë më studentet në vitin 2019 është vendosur dhe buxhetuar nga bashkia ne lidhje me kartat e studenti,e cila duhej t'i siguronte atyre mjaft fasilitete dhe benefite.Duke marr parasysh edhe kushtet e pandemisë ,ky fond vazhdon të mbetet i paprekur dhe nga ana e bashkisë nuk ka asnjë nismë për këtë.Znj.Leqejza dëshiron të dijë:-Cfarë masash janë marrë nga bashkia në lidhje me këtë problem dhe a ekziston një plan mobiliteti?Gjithashtu ajo i bën thirrje të gjitha grupeve të interesit,sidomos studentëve,që të behen pjesë e konsultave,sugjerimeve dhe cdo ankesë që ato kanë,meqënëse në muajin tetor do të bëhen edhe konsulta për buxhetin e vitit 2022.

Z.Deda merr fjalën dhe shprehet se pyetjet e shtruara nga Z.Leqejza kërkojnë përgatitjen dhe angazhimin e disa drejtorive në bashki prandaj nevojitet një konsultim me Kryetaren e bashkisë paraprakisht për të dhënë një përgjigje sa më të drejtë.Bashkia dhe stafi teknik i saj mund të japin një përgjigje me shkrim për këtë.

Znj.Kadia thekson se në bazë të rregullores pyetjet që këshilltarët bëjnë më zë kerkojnë përgjigje me zë,prandaj Znj.Leqejza duhet të marr përgjigje ne mbledhjen e ardhshme.

Znj,Leqejza shprehet dakort edhe për një përgjigje me shkrim,meqënëse ky problem kërkon shqyrtim edhe të komisionit për qështjet publike.

Fjalën e merr Znj.Brigja,e cila shpreh shqetësimin e banorëve të zonës tek Ura e Bardhajve në lidhje me rrugën në atë zonë.Po ashtu ajo kërkon të dijë edhe nëse ka ndonjë projekt investimi për shkollën e Gucisë për mungesë ambientesh.

Z.Deda merr fjalën dhe sqaron se për rrugën tek Ura e Bardhajve ka një projekt shumë të mirë me të gjitha standardet dhe punimet do fillojne shumë shpejt.Po ashtu ai do i propozojë kryetares së bashkisë që investimi në shkollën e Gucisë të jetë prioritet ne buxhetin e vitit tjetër.

Fjalën e merr Z.Hallunaj,i cili kërkon të dijë në lidhje me disa rrugë të qytetit,konkretisht;Rr."Fadil Podgorica","Xhelil Mehmet Fishta" dhe "Prel Morina",të cilat janë të parashikuara në buxhetin e vitit 2021 por janë akoma të papërfunduara.Sipas administratës së bashkisë ato vazhdojnë të jenë në projektim.Po ashtu Z.Halluni shpreh shqetësim për trafikun e rënduar që krijohet tek rruga "Fahri Ramadani".Ai propozon që ai segment të bëhet me orar të kufizuar lëvizjeje.Tjetër propozim është edhe përfshirja ne buxhetin e ardhshëm shkollën "Xheladin Fishta" për mungesë

ambjentesh.Vijon me pergjigjet Z.Deda,i cili sqaron se persa i përket rrugëve të sipërpërmendura,duhet konsultim me specialistët përkates.Dhe do ketë një përgjigje me shkrim për këtë.

Z.Vukaj merr fjalën dhe shpreh shqetësimin e përsëritur në lidhje me prezencën e Policisë Bashkiake në qytet dhe manaxhimin e hapësirave publike.Ai kërkon të dijë nëse ka ndonjë plan masash për këtë?

Z.Deda merr fjalën dhe pohon që ekziston një plan dhe po vihet në efiçencë.Besojme se do vihet re edhe ndryshimi.

Merr fjalën Z.Petani,e cila flet për një shqetësim të banorëvë të lagjes "Perlat Rexhepi" në lidhje me kutitë e Ujësjellësit,që po bëhën shkak konfliktesh mes banorëve.Po ashtu Z.Petani kërkon të vihet dore edhe tek rruga tek varret e Stom Golemit.Dhe propozon edhe shtim në numër te kazanave të mbeturinave.

Z.Deda pergjigjet se nuk ka informacion përsa i takon kutive të ujësjëllësit por do ketë patjetër një reagim.Po ashtu shpreh dakordësi për rrugën e përmendur.Ai sqaron se koshat e mbeturinave jane të vendosur në raport me numrin e banorëve të zonës.

Përsëri fjalën e merr Z.Leqejza ,e cila rikujton që ne buxhetin e vitit 2021 është trajtuar problemi i shfrytëzimit dhe vjeljes së taksave të hapësirave publike.Është rënë dakort se deri ne Mars 2021 do kishin edhe një rregullore për këtë,por akoma nuk ka asnjë veprim për t'i ardhur në ndihmë qytetarëve.

Tjetër shqetësim paraqet Z.Ndreu,në lidhje me rojet e shkollave.Ajo kërkon që në mbledhjen e ardhshme të këshillit të jetë i pranishëm një përfaqësues i zyrës arsimore të bashkisë,i cili të sqarojë funksionimin e sistemin të ri të rojeve.

Z.Deda shprehet se ne bazë të informacionit që ai ka ,është bërë një qarkullim rojesh për të përmirësuar shërbimin megjithatë sqarime me të sakta do t'i jap specialisti i zyrës së arsimit. Z.Metushi shprehet dakort me të gjitha shqetësimet e parafolësve dhe thekson se shkollat kanë probleme të shumta duke filluar nga transporti e deri tek ngrohja në shkolla.Prandaj propozon të shihet si prioritet dhe jetë e detyrueshme pjesmarrja e specialistit te zyrës së arsimit në mbledhjen e ardhshme.Po ashtu kerkon të njihet edhe me grafikun e pastrimit të qytetit,sepse shpeshherë bëhet shkak për rëndesë trafiku.Z.Deda merr fjalën dhe sqaron që ai u mundua t'i japë përgjigje cdo pyetjeje me sa infomacion që dispononte,megjithatë në menyrë me të detajuar mund të sqarojnë specialistët e zyrave përkatëse.Pyetje e diskutime te tjera nuk ka.Kryetarja e këshillit deklaron të mbyllur mbledhjen.

Sekretar

Denis LESHA

KRYETARE

Brisela KADIJA